



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

PROJEKTVENDIM

NR. ____, DATË __/__/202__

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 LEKË PËR OBJEKTIN
"LIDHJA E ENERGJISË DHE UJESJELLËSIT NË ZONËN
E RE PËR ZHVILLIM SPITALLË"**

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025"; Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor 2025-2027", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës publike, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 (tremilion) lekë për objektin: "Lidhja e energjisë dhe ujësjetllësit në Zonën e Re për Zhvillim Spitalle".
2. Efekti financiar sipas pikës I do të sigurohet nga fondi rezerve i buxhetit të bashkisë Durrës të vitit 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor 2025-2027".
3. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtore
Valbona Qiliako

**DREJTORIA E PROJEKTEVE
DHE E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE**

Drejtore
Lorenc Façja

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore
Almida Boshni

KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 LEKË PËR
OBJEKTIN "LIDHJA E ENERGJISË DHE UJESJELLËSIT NË ZONËN E RE PËR
ZHVILLIM SPITALLË"**

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor 2025-2027", Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike paraqet relacionin si mëposhtë vijon:

Në kuadër të procesit të rindërtimit, aktualisht punimet e objekteve të rindërtuara në zonën e re për zhvillim Spitallë, janë drejt përfundimit, dhe me qëllim shpërndarjen e tyre tek familjet përfituese është e domosdoshme dhe lidhja e energjisë elektrike në këtë zonë. Kjo parashikon lidhjen e energjisë elektrike për apartamentet por dhe për elektrifikimin e të gjithë zonës, proces i cili do të realizohet nga OSHEE-ja, dhe ky fond i parashikuar shërben për pagesat që kryhen ndaj këtij institucioni për të realizuar lidhjen e energjisë.

Përsa më sipër ju kërkojmë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 (tremilion) lekë për objektin: "Lidhja e energjisë dhe ujesjellësit në Zonën e Re për Zhvillim Spitallë".
2. Efekti financiar sipas pikës 1 do të sigurohet nga fondi rezerve i buxhetit të bashkisë Durrës të vitit 2025, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, si dhe programin buxhetor 2025-2027"

**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE
INRASTRUKTURËS PUBLIKE**

**Drejtore
Lorenc Pacja**

DREJTORIA E BUXHETIT

**Drejtore
Valbona Qiriako**